



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS GLLOGOC

Numri i lëndës: 2021:056794

Datë: 30.01.2024

Numri i dokumentit: 05261013

C. nr. 101/2021

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEGA NË GLLOGOC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni civil, me gjyqtarin Astrit Gashi me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Remzi Duli, në çështjen juridike kontestimore të paditësit I.H nga Komuna Gllogocit, të cilin e përfaqëson i autorizuari i tij sipas autorizimit S.Z, nga Gllogoci, kundër të paditurës Komuna e Gllogocit, Drejtoria për Arsim, me objekt kontesti kompensim i shujtës ditore, me vlerë të kontestit prej 284.00 €, jashtë seancës gjyqësore më datën 29.01.2024 e mori këtë:

A K T G J Y K I M
PA SHQYRTIM KRYESOR TË ÇËSHTJES

- I. APROVOHET** në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit **I.H** nga Komuna Gllogocit, dhe **DETYROHET** e paditura Komuna e Gllogocit, Drejtoria për Arsim në Gllogoc që paditësit ta ia kompensoj në **emër të shujtave ditore** shumën prej **284.00 €** për 142 ditë të pranisë në punë për periudhën kohore prej datës 18.04.2017 deri me datën 01.02.2018, me kamatë ligjore prej 8% në vit duke filluar nga data 25.03.2021 kur është paraqitur padia e deri në pagesën përfundimtare, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 125 €, të gjitha këto në afat prej shtatë (7) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënimin e përmbarrimit ligjor.
- II. REFUZOHET** si e pabazuar kërkesa e paditësit që të detyrohet i padituri të ia paguaj edhe shpenzimet procedurale kontestimore mbi shumën e aprovuar nga pika I të këtij dispozitivi.

A r s y e t i m

Paditësi, me datën 25.03.2021, kundër të paditurës për kompensim të shujtës ditore për periudhën kohore prej dt.18.04.2017 deri me dt.01.02.2018, duke theksuar se paditësi ka themeluar marrëdhënie pune në SHFMU "M..." në fsh..., Komuna Gllogoc, Mësimdhënës i Lëndës Histori-Gjeografi. Paditësi ka ushtruar kërkesë në procedurë jashtëgjyqësore për kompensimin e shujtave dhe shpenzimeve të udhëtimit tek e paditura duke u bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit të datës 18.04.2017 por të njëjtit i është refuzuar kërkesa, dhe meqenëse e paditura nuk e ka përmbushur detyrimin në mënyrë vullnetare ka kërkuar nga gjykata që kërkesëpadinë e tij ta aprovoj si të bazuar. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura, me anë të përgjigjes në padi **nuk ka kontestuar se paditësi është në marrëdhënie pune** te e paditura por e ka kontestuar kërkesëpadinë e tij duke theksuar se kërkesëpadia bazohet në kontratën kolektive të vitit 2017 e cila nuk parasheh veprim retroaktiv për realizimin e të drejtës së kërkuar me padi, dhe se të njëjtit nuk i takon kompensimi i shujtës sepse **nuk është anëtar i sindikatës (SBASHK)**. Tutje

ka theksuar se kërkesa e paditësit për shujtë ditore nuk ka bazë ligjore sepse Kontrata kolektive e Arsimit ka qenë e vlefshme deri me datën 18.04.2020, dhe se sipas Kontratës Kolektive të Arsimit të vitit 2021 në nenin 45 para. 1 përcakton qartë se punëdhënësi ka afat për sigurimin e mjetve financiare për kompenzimin e kësaj kategorie të pagave deri në vitin 2023 dhe rrjedh se punëdhënësit ende nuk i ka skaduar afati për sigurimin e mjeteve financiare që do të thotë se pala paditëse ende nuk i ka shterur mjetet e brendshme juridike për realizimin e të drejtave të tyre konform Nenit 79 të Ligjit të Punës. Ka paraqit edhe pretendimin se: *ushqimi nuk është borgj kryesor ose dëm ndaj paditësit ashtu që i njëjti nuk ka të drejtë as në kamatë.*

Gjykata ka pasur parasysh përgjigjen në padi të të paditurës kur ka theksuar se kërkesëpadija bazohet në kontratën kolektive të vitit 2017 e cila nuk parasheh veprim retroaktiv për realizimin e të drejtës së kërkuar me padi dhe se të njëjtit nuk i takon kompensimi i shujtës sepse **nuk është anëtar i sindikatës (SBASHK)** por ditët e punës janë llogaritur nga vet e paditura në Vërtetimet nr... të datës 25.03.2021, sipas të cilave paditësi nga periudha prej datës 18.04.2017 e deri me datën 01.02.2018 ka pasur 142 ditë aktive në punë. Edhe pse e **paditura e ka kontestuar kërkesëpadijën e paditësit, e njëjta nuk i ka mohuar faktet vendimtare** sepse për të **nuk ka qenë** kontestuese se paditësi është mësimdhënës tek e paditura, përveç që e ka kontestuar se kontrata kolektive vitit 2017 ka qenë në fuqi gjer në vitin 2020, i padituri **nuk e ka kontestuar se të njëjtit i takon e drejta e kompensimit të shujtës ditore në bazë të kontratave kolektive sektoriale** me vet faktin se ka theksuar se *“paditësi nuk duhet kompensuar shujtat për një kontratë të skaduar”*.

Në lidhje me pretendimin e të paditurit se paditësi nuk është anëtar i SBASHK-ut andaj nuk ka të drejtë në shujtë, gjykata vlerëson se nuk është i bazuar sepse nuk është kusht i domosdoshëm për të realizuar të drejtat nga marrëdhënia e punës në sektorin e arsimit. Sa i përket pretendimit se kontrata kolektive nuk ishte në fuqi nga data 18.04.2020 kjo nuk është e bazuar, për shkak se Neni 45 i Kontratës Kolektive të vitit 2017 nr. 2056 të datës 18.04.2017 përcakton se: *nga kontrata kolektive palët mund të tërhiqen tre muaj para skadimit të vlefshmërisë së saj përmes letrës rekomanduese e cila tërheqje fillon së zbatuar. Në ditën e nënshkrimit të kontratës së re. Nëse kontrata kolektive pasi të i skadoj afati i përcaktuar nuk tërhiqet asnjëra palë zbatimi i saj vazhdon edhe një vit. Pas skadimit të afatit të kontratës kolektive lidhet kontratë e re. Në fillimin e punës së kontratës së re në gjashtëmuajorin e parë aplikohen rregullat e kontratës së vjetër”*. Kjo nënkupton se për periudhën prej 18.04.2020 gjer në lidhjen e kontratës së re kolektive me datën 22.01.2021 me nr. 105 aplikohet kontrata e vjetër dhe atë edhe 6 muaj pas hyrjes në fuqi të kontratës së re gjer me datën 22.07.2021, dhe në vazhdim gjer në 22 nëntor 2022 aplikohet kontrata e re kolektive e vitit 2021. Në lidhje me pretendimin tjetër se *ushqimi nuk është borgj kryesor ose dëm ndaj paditësit ashtu që i njëjti nuk ka të drejtë as në kamatë, kjo nuk është e bazuar për shkak se kompensimi për ushqim është e drejtë nga marrëdhënia e punës dhe rrjedhimisht kërkesë kryesore.*

Gjykata, pas pranimit të përgjigjes në padi, i ka vlerësuar kushtet ligjore nga Neni 152 i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me të cilin përcaktohet se *“po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadijës, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim”* lidhur me Nenet 143 dhe 147 të të njëjtit ligj, nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij, dhe ka gjetur se në këtë çështje juridike kontestuese plotësohen kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit pa shqyrtim kryesor.

Gjykata, duke pasur parasysh faktin se e paditura nuk i ka mohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadijës, ka vlerësuar se në këtë çështje juridike kontestuese nuk është e nevojshme mbajtja e shqyrtimit kryesor dhe administrimi i provave për faktet e pohuara.

Andaj, gjykata, konform Nenit 152 të LPK-së gjeti së kërkesëpadija e paditësit është e bazuar dhe vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke iu referuar dispozitave të Nenit 35 paragrafi 7 të Kontratave Kolektive të Arsimit në Kosovë nr. 2056 të datës 18.04.2017 dhe asaj nr. 105 të datës 22.01.2021 në fuqi gjer me datën 22.11.2022 (me dispozita të njëjta në të dy kontratat) – ku përcaktohet se *“Të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditës e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimeve të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro për të punësuarit të cilët kanë marrëdhënie pune primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi i cili e ka të rregulluar*

ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit a kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensimin për ushqim”. Po ashtu me nenin 35 para. 5 të Kontratave Kolektive të Arsimit në Kosovë, parashihet se “Punonjësit arsimor që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse i paguhen shpenzimet e rrugës të 70% të trafikut urban .”.

Gjykata me rastin e vendosjes për paditësin lidhur me kompensimin e shujtës është bazuar në Vërtetimet e SHMU “M...” nr... të datës 25.03.2021, sipas të cilave paditësi nga periudha 18.04.2017 deri më 01.02.2018 ka pasur 142 ditë aktive në punë, ndërsa sipas Aktvendimit me nr... të datës 16.01.2018 paditësi është shkëputur marrëdhënia e punës në bazë të ligjit të punës për shkak të pensionimit, paditësi ka pasur gjithsej 142 ditë aktive pune të cilat kur shumëzohen me 2 € për një shujtë ditore sipas Kontratës Kolektive të Arsimit të vitit 2017 del që shuma për kompensimin e shujtës për paditësin duhet të jetë 284.00 €.

Kamata ligjore është vendosur në kuptim të dispozitave të Nenit 382 të LMD-së.

Vendimin që pala e paditur t’i bartë shpenzimet e procedurës gjykata e ka mbështetur në dispozitat ligjore konform Nenit 449 dhe 452 të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Lartësia e këtyre shpenzimeve të aprovuara u referohet, përpilimit të padisë në shumën prej 104 € dhe për taksën gjyqësore për padi në shumën prej 21 €, apo shumën e tërësishme të tyre prej 125 €. Kurse vendimin nga pika II e dispozitivit me të cilën është refuzuar kërkesa e paditësit për shpenzime procedurale lidhur me: *për seancë gjyqësore në shumën prej 135 €, gjykata e ka mbështetur në Nenin 453 par. 1 lidhur me Nenin 463 par. 1 të LPK-së, e njëjta nuk është e arsyetuar, dhe nuk janë shpenzime që kanë qenë të nevojshme për ndjekjen e çështjes në gjyq, kjo për faktin se nuk është e mbajtur ndonjë seancë gjyqësore sepse është vendosur me aktgjykim pa shqyrtim të çështjes.*

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEGA NË GLLOGOC,
Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni civil, C. nr. 101/2021, me datë 29.01.2024**

**Gjyqtari
Astrit Gashi**

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit të tij pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate.